Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci,zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e kosos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2016 janë :

EURO :	LEK	135.23
USD :	LEK	128.17

Kostot e huamarrjes

Kostot e huamarrjes përfshijnë interesin e paradhenieve bankare dhe huaveafatshkurtera dhe afatgjata. Kostot e huamarrjes njihen si shpenzim në periudhën që ato janë shkaktuar pavarësisht se si huatë janë aplikuar .

Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për të paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem për vitin . Fitimi i tatueshem ndryshon nga fitimi neto që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sepse ai përjashton zëra të të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshme apo të zbritshëm në vite të tjera dhe gjithashtu përjashton zëra që nuk janë kurrë të tatueshem apo të zbritshëm . Detyrimi i shoqërisë për tatim fitimin e vitit llogaritet duke përdorur normat e tatimit të përcaktuara nga legjislativi shqiptar për kontabilitetin në Shqipëri . Norma aktuale e tatimit mbi fitimin është 15 %

Kërkesat për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar e kërkesave për t'u arkëtuar afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provizionet e krijuara për rënje në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Detyrimet financiare

Detyrimet financiare janë klasifikuar sipas llojit të marrëveshjes kontraktuale.

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Risku i kreditimit

Risku i kreditimit të Shoqërisë kryesisht i vishet kërkesave për arketim dhe aktiveve të tjera të saj . Gjendjet e paraqitura në bilancin kontabel zvogëlohen nga provizionet (shumat e parashikuara) për kërkesat e dyshimta për arketim , të vlerësuara nga drejtimi i shoqërisë mbi bazën e experiences së mëparshme dhe vlerësimit të mjedisit ekonomik aktual .Shoqëria nuk ka kërkesa të dyshimta dhe nuk ka krijuar provigjone të tilla.

Shoqëria nuk ka përqendrim të rëndësishëm të riskut të kreditimit , me një zbulim të shpërndarë në një numër të madh të tretësh dhe klientësh .

Aktivet afatgjata materiale (AAM-te)

Aktivet afatgjata materiale(AAM-të) paraqiten me shumën e rivlerësuarë minus zhvlerësimin . Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me koston historike minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalin e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi është llogaritur mbi bazën e gjyqimit që ka bërë drejtimi , duke ngarkuar pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si më poshtë . Ai është me i vogël se amortizimi fiskal.

Makineri e pajisje	2% vlere e mbetur
Pajisje zyre	20% vlere e mbetur

Inventaret

Inventaret jane paraqitur me koston mesaare historik pasi vlere neto realizueshme eshte praktikisht e pamundur te percaktohet.

Kosto perbehet nga kosto e blerjes direkte , tarifat doganore dhe tarifate e transportit.

Per ndjekjen dhe inventarizimin e mallrave eshte perdorur metoden e koston mesatare .

Aktive monetare (likuiditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e llogarive te likuiditeteve te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike temonedhave. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, jane konvertuar ne leke duke përdorur kursin e këmbimit të fundit te ushtrimit te bankes se Shqiperise.

Te Drejta te arketueshme

Ne "Llogari /Te Ushtrimit jane pasqyruar vlerat e faturave te pa paguara nga klientet .Shoqeria ka te evidentuar ne menyre analitike secilin klient.

Shumat e paraqitura ne "Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme" / Tatim fitimi perfaqesojne tepricen debitore te "Shteti-per deyrimin e paguar per tatim fitimin e mbipaguar deri me 31.12.2016 .

Drejtimi mendon se te gjitha kerkesat do te arketohen ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.

Aktivitet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2016.Si politike kontabel per kontabilizimin dhe spjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston(SNK-5).Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar .

Drejtimi mendon se pergjithesisht per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renjes ne vlere te AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime.

Metodat dhe normat e amortizimit te AAM-ve te perdorura nuk jane njejta me ato qe perdoren per qellime fiskale.Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijte e njohur per efekte fiskale. Drejtimi ka cmuar shumen e amortizimit te kaluar ne shpenzime si shumen e drejte.

Detyrime afatshkurtera

"Detyrime ndaj Institucioneve te kredise" perben huane afat shkurter ne formen e linjave te kredise te marra prane Credins Bank.

"Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit" perbehet nga detyrimi i papaguar ndaj furnitoreve deri ne 31.12.2016 per te cilat eshte pergatitur inventari perkates.

"Detyrimet tatimore" perfaqesojne detyrimet per detyrimet e muajit dhjetor 2016.

Te gjitha keto detyrime jane shlyer ne muajin Janar 2017.

Drejtimi mendon se te gjitha te pagueshmet ndaj te treteve do te likujdohen ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.

Huamarrjet Afatgjata

Huamarrjet afatgjata jane hua te marra nga te trete per blerjen e kuotave te Bankes Credins.

Kapitalet e veta

Kapitali i rregjistruar i shoqërise, i paraqitur në bilanc, është i njëjte me atë të përcaktuar në statutin e shoqërise dhe vendimet e depozituara në QKR. Me 31.12.2016. Ai është 100.000 leke, i ndarë në 2 kuota me vlerë nominale 50.000 leke.

Gjate ushtrimit kontabel 2016 nuk ka rritje ose pakesim në vlerën e kapitalit, por kanë ndryshuar raportet e zoterimit nga ortakët. Gjate vitit 2016 ka ndodhur largimi i ortakut znj Odeta Nace dhe shtimi i ortakëve, z. Fuad Haxhiymeri dhe z. Agron Haxhiymeri.

Shpenzimet e veprimtarisë kryesore

Konsumi i materialeve, mallrave, furniturave, punimeve e shërbimeve, të pasqyruara në dokumentat justifikues, janë rregjistruar me shumat e paguara ose të pagueshme.

Kostoja e punësimit, page dhe sigurime shoqërore, është pasqyruar saktësisht si shpenzim me vlerën e realizuar dhe të dokumentuar.

Taksat lokale e taksat e tatimeve të tjera që lidhen me biznesin janë llogaritur dhe pasqyruar në llogaritë e ushtrimit.

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Janë paraqitur si diferencë e të ardhurave me shpenzimet sipas kërkesave të standarteve.

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Tatim fitimi i ushtrimit është i llogaritur mbi fitimin e tatueshëm, i cili është rregulluar nga shpenzimet e pajohura sipas legjislacionit fiskal, analizuar në tabelën e mesipërme.


Si shpenzime të pazbriteshme janë konsideruar shumat e interesave bankare mbi 4-fishin e kapitaleve të veta, gjërat dhe kamatat.

➤ **Te tjera**

Pasqyra e Fluksit Monetar të vitit 2016 është e ndërtuar me metodën indirekte në përputhje me SKK-të. Pasqyra e ndryshimit në kapital është ndërtuar në përputhje me SKK-të dhe është e barabartë me rubrikën Kapitali, në Pasivët në Bilancin kontabël pjesë e Pasqyrave Financiare. Asnjë ngjarje e rëndësishme nuk ka ndodhur pas datës së miratimit të pasqyrave financiare.

Shoqëria është në konflikt gjyqësor me Drejtorinë e Tatimeve për të kundërshtuar kërkesën e tyre për faliment (nga humbje që vazhdon prej disa vjetësh)

Administratori
Fuad Haxhiymeri


Nr. NIPT / TEL. +355 4 240157
K32419001R

KONTRATË

Lidhur, në Tiranë, më datë 04.01.2017, midis:

Z. MIMOZA MANA, Perfaqesuesi e Zyres Kontabilitetit me profesion "Kontabël i miratuar" me adresë sami Frasheri Pall83 ap 12 që më poshtë do të quhet "KONTABILISTI" dhe

Shoqërisë " **"PRIMA" SHPK** NIPT K32419001R përfaqësuar nga administratori Xhoxhi Mita që më poshtë do të quhet "KLIENTI"

KUSHTE TË KONTRATËS

NENI 1

Objekti i kontratës

- 1.1 Objekti i kësaj kontrate është përcaktimi i kushteve, detyrimeve dhe të drejtave të ndërsjellta midis "KONTABILISTIT" dhe "KLIENTIT" për shërbimin e ofruar.

NENI 2

Tarifat, Afati, Pagesat

- 2.1 Tarifat që ofrohen për "KLIENTIN" janë ato të parashikuara me marreveshje të veçante. Çdo ndryshim i tarifave behet me miratimin e paleve.
- 2.2 Kjo kontratë lidhet me një afat të pacaktuar.
- 2.3 Rinovimi i kontratës bëhet me miratimin e paleve.
- 2.4 Pagesat nga "KLIENTI" bëhen sipas marreveshjes së përcaktuar të 2.1.

NENI 3


Detyrimet


3.1 "KONTABILISTI" detyrohet:

- 3.1.1 Të mbajë llogaritë e "KLIENTIT", dhe të përgatisë bilancet në përputhje me kërkesat ligjore në bazë të dokumentave kontabël që i vihen në dispozicion nga klienti.
- 3.1.2 Të sigurojë regjistrim korrekt dhe brenda afateve të përcaktuara ligjërisht.
- 3.1.3 Të hartojë, me kërkesë të Klientit, raporte dhe t'ia dorëzojë ato "KLIENTIT".
- 3.1.4 Të evidentojë ankesat dhe kërkesat e "KLIENTIT" dhe të marrë masat për eliminimin e tyre.
- 3.1.5 Të mbajë lidhje të vazhdueshme me organet tatimore, të terheqë dhe të dorëzojë në organet tatimore dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar me ligj.
- 3.1.6 Të mos publikojë të dhënat kofidenciale, që demtojnë aktivitetin e klientit.

3.2. "KLIENTI" detyrohet:

- 3.2.1 Të pranojë dhe të ruajë dokumentacionin zyrtar që merr në dorëzim nga "KONTABILISTI"


ZYRE KONTABILITETI
MIMOZA MANA
NIPT K32419001R


Prima
Rr. Kavajës - Tel. +385 4 240157
Nr. NIPT K32419001R

- 3.2.2 Të vëre në dispozicion të "KONTABILISTIT" dokumentacionin e nevojshëm kontabel
- 3.2.3 Të krijojë kushte për kryerjen e aktivitetit normal të punës nga "KONTABILISTI"
- 3.2.4 Të likujdojë faturat për të gjitha shërbimet e kryera nga kontabilisti, brenda muajit pasardhës, në përputhje me marreveshjen.
- 3.2.5 Të ruajë dokumentacionin vërtetues të likujdimeve të kryera prej tij për "KONTABILISTIN".


NENI 4 Të drejtat

- 4.1 "KONTABILISTI" ka të drejtë :
 - 4.1.1 Të kërkojë përmirësimin dhe ndryshimin e menyres së regjistrimeve nëse konstaton se nuk janë zbatuar kërkesat ligjore të mbajtjes së regjistrimeve
 - 4.1.2 Të bëjë ndryshime dhe përmirësime në Akt-verifikimet dhe dokumenteve vërtetuese
- 4.1 "KLIENTI" ka të drejtë:
 - 4.2.1 Të mos pranojë raporte që nuk plotësojnë kushtet: sic janë raportet e hartuara pa kryer kontrollin e dokumentacionit, etj.
 - 4.2.2 Të kërkojë me shkrim përmirësime ose specifikime të kushteve të kontratës
 - 4.2.3 Të kërkojë lidhjen e një kontrate të re, në rastet kur "Kontabilisti" ka prishur kontratën e mëparshme.
 - 4.2.4 Të kërkojë me shkrim prishjen e kontratës në mënyrë të njëanshme, kur e gjykon se ka mosmarreveshje, të vertetuara zyrtarisht, me "Kontabilistin"

NENI 5 Kushte të përgjithshme

- 5.1 Kushtet e përgjithshme të kësaj kontrate janë:
 - 5.1.1 Palët marrin përsipër të respektojnë kushtet e kontratës.
 - 5.1.2 Mosmarreveshjet që lindin ndërmjet palëve dhe që nuk arrijnë të zgjidhen me mirëkuptim, brenda 1 (një) muaji, i kalojnë për shqyrtim Gjykatës së Rrethit ku është lidhur Kontrata.
 - 5.1.3 Kjo kontratë hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga palët
 - 5.1.4 Kontrata është e vlefshme për sa kohë që palët nuk kanë kërkuar me shkrim prishjen e saj të njëanshme.

Për "ZYREN E KONTABILITETIT"
KONTABËL I MIRATUAR




Për "PRIMA "SHPK
ADMINISTRATOR

FUAD HAXHIYMERI

Prima
Rr. Kavajës - Tel. +355 4 240157
Nr. I. PT K32419001R

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
Nr. 263 Rep. 61 Kol.



KONTRATE QIRAJE

Sot me datë 01.04.2008(dymije e tete) para meje Noter Asim Zeka me zyre ne rrugen "George W Bush" ne Tirane u paraqiten personalisht palet:

QIRADHENES: Shoqeria "BLOJA"sha regjistruar ne Gjykate me vendimin nr.11826 date 07.08.1995 te Gjykates se Rrethit Tirane dhe NIPT J61817056C, perfaqesuar nga Administratori **Fuat HAXHIYMERI**, banues ne Tirane, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, i njohur .

QIRAMARRESI:Shoqeria "PRIMA"shpk regjistruar ne Gjykate me Vendimin nr.30055/4 date 26.10.2006 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane dhe NIPT J61817056C perfaqesuar nga Administratoria Odeta MUÇA, madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar, e njohur.

OBJEKTI DHE DETYRIMET

Qiradhenesi është pronar i Fabrikes se Blojes Tirane,regjistruar ne ZRPP Tirane me Nr. 5133 date 04.07.1998.-----

Qiradhenesi deklaroi se do ti japi me qera qiramarresit nje magazine me siperfaqe 80 (tetedhjet) m² e cila ndodhet ne afersi te magazines se ambalazhit.. Qiramarresi deklaroi se do ta marri me qira magazinën.-----

Afati i qirase do te jete **Dhjetë vjet** dhe do te filloje sot me date 01.04.2008 deri me date 31.03.2018. -----

Qiraja mujore do te jete **30.000(Tridhjetemije) Leke** dhe do te paguhet nga qiramarresi deri ne date **05** te cdo muaji.-----

DETYRIME TE PERBASHKETA

Ne qoftese palet deshirojne te zgjidhin kete kontrate perpara aftit te caktuar, jane te detyruar te njoftojne njeri tjetrin tre muaj perpara zgjidhjes se kontrates me shkrim. -----

Qiramarresi eshte detyruar te ruaje dhe te mirembaje magazinën .

Qiramarresi ka te drejte te beje investime ne kete objekt d.m.th ndryshime ne strukturen e magazines.-----

Qiramarresi nuk ka te drejte te japi magazinën me nenqira.-----

Qiradhenesia i garanton qiramarresit se pervec tij nuk ka persona tjeter qe te pretendojne per pronesine e magazines.-----



Qiramarrësi do të paguaj energjin elektrike dhe ujë.-----
Te gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim dhe në rast se nuk arrihet mirëkuptimi, secila palë ka të drejtë të drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve .-----

Për sa nuk parashikohet në këto kontrata, të dyja palët detyrohen të zbatojnë dispozitat e kodit civil (kontrata e qiras) nëni 801 e vijues.-----

Palëve ju lexua dhe shpjegua përmbajtja e kësaj kontrate e pelqejne dhe e neneshkruajne rregullisht. Une noter e vertetoj sipas ligjit

PALET

QIRAMARRËSINI
Shoqëria "PRIMA" shpk
Administrata

QIRAMARRËSI
Shoqëria "PRIMA" shpk
Administrata

NOTER
ASIM ZEKA
TIRANE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË PËR VËRTETIM PRONËSIE

749435

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. TIRANË Zona Kadastrale Nr. 8240
 Numri i Pasurisë 2/138 Volumi 3 Faqe 23
 Adresa e Pasurisë Tirane Rruga RR.3 DESHMORET
 Lloji i Pasurisë TRUALL
 Sipërfaqja Totale 5930.00
 Nga kjo : Sa Truall 5.930.00 Nga kjo : Sa Ndërtesa 2.490.00
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes _____ %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
"BLOJA"SH.P.K			0 / 100	TIRANË Rruga BRIGADA 8

- është pronar i _____ pasurisë me numër 2/138
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart _____
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi _____
- kufizimet e pasurisë janë : V _____, L _____, J _____, P _____

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga _____ (interesuarit (t)) më datë _____

Data e lëshimit të çertifikatës

18/7/2013





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË PËR VËRTETIM PRONËSIE

749711

Z.V.R.P.P. TIRANË
 Zona Kadastrale Nr. 8240
 Zyra e Regjistrimit
 Numri i Pasurisë 2/137
 Volumi 3 Faqe 24
 Adresa e Pasurisë Tirane Rruga RR.3 DESHMORET
 Lloji i Pasurisë TRUALL
 Sipërfaqja Totale 4320.00
 Nga kjo : Sa Truall 4,320.00 Nga kjo : Sa Ndërtesa 1,230.00
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
"BLOJA"SH.P.K--			1/1	

- është pronar i pasurisë me numër 2/137
- janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi
- kufizimet e pasurisë janë : V _____ L _____ J _____

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga të interesuarit(t) më datë

Data e lëshimit të certifikatës

18/7/2013

REPUBLIKË E SHQIPËRISË
 ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME
 TIRANË
 Lëshuesi i certifikatës
 REGJISTRUESI
 (FETAH HASANAJ)


HARTA TREGËSË E REGJISTRIMIT
(Fragment)

ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT
TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
TIRANË

REGJISTRUES

FETAH HASANAJ

Vula



A. IDENTIFIKIMI I PASURISË

ZONA KADASTRALE 8240 NR. PASURISË 21137, VOL. 3, FQ. 24

INDEKSI I HARTËS TN-Q12-S1C, SHKALLA 1:1000

ADRESA E PASURISË: Rrethi TIRANË, Q/ TIRANË

Rr/ KAVAJES, P/G _____, Sh _____, K _____, Ap _____

B. KUFIZIMET

C. PRONARI

V. 2145


L. 1015


J. 1015

P. 21138

D. Data: 09/08 /2011, Ora _____, Punoj: _____

"BLOJA" SH.P.K.





RAPORT

**I EKSPERTIT KONTABEL TE REGJISTRUAR
PER AUDITIMINE BILANCIT TE VITIT 2016**

"PRIMA" SHPK TIRANE

EKSPERT KONTABEL I REGJISTRUAR

Lefteri KUSHTA

Mars 2017



RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR


Për Ortaket e Shoqërisë Tregtare " PRIMA " sh.p.k

Opinionin me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë tregtare " PRIMA " sh.p.k , të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2016, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Si pas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të çështjeve të përshkruara në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë të raportit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të) në Shqipëri.

Baza për opinionin me rezervë



Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në [juridiksionin], dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera të ndryshme nga Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë çdo informacion financiar ose jo financiar që jepet në raportin vjetor që mund të publikohet si një dokument i vetëm, ose një kombinim i dokumenteve, por që ndryshojnë nga pasqyrat financiare të audituara dhe raporti i audituesit mbi këto pasqyra.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat

financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se janë me anomali materiale. Nëse, bazuar në punën e kryer, ne arrijmë në përfundimin se në këto informacione ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt. Ne, nga informacionet që kemi siguruar para datës së raportit të audituesit, nuk kemi asgjë për të raportuar.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit(SKK-të), dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk një është garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Një përshkrim më i detajuar i përgjegjësive të audituesit për auditimin e pasqyrave financiare mund të gjendet në shtojcën bashkangjitur raportit. Ky përshkrim përbën pjesë të raportit tonë të auditimit.

EKR Lefteri KUSHTA

Rr. Don Bosko, Pall. Aurora Konstruksion, Tirane



20/03/2017

Shtojcë e raportit të audituesit


Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.
- Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.
- Ne lexojmë dhe të vlerësojmë informacionet e tjera, për arsye se informacionet e tjera mund të kenë inkoherenca (mospërputhje) materiale me pasqyrat financiare ose më njohjen e siguruar nga audituesi gjatë auditimit, mund të tregojnë se ka një anomali materiale në pasqyrat financiare ose që ekziston një anomali materiale në informacionet e tjera, ku çdonjëra prej tyre mund të dëmtojë besueshmërinë e pasqyrave financiare dhe të raportit të audituesit mbi këto pasqyra. Këto anomali materiale mund të influencojnë në mënyrë të papërshtatshme vendimet e përdoruesve për të cilët është përgatitur raporti i audituesit.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DOMA E NOTEREVE TIRANE
Noter Artan TRESKA
Rruga e "Kavajës"
Tel. 0682140355



Nr. 1932 Repertori. Nr. 364 / Koleksioni.

KONTRATE QIRAJE

Sot në datë 25/04/2016 në Studion Noteriale të ndodhur në Rrugën e "Kavajës", Tiranë para meje noterit **Artan TRESKA** u paraqitën personalisht palët si më poshtë të cilët me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë kërkuan redaktimin e kontrates së qirasë në bazë të neneve 801 e vijues të Kodit Civil:

QIRADHENESI: **Artan ZENELI** i biri i Nuh i datelindjes 31/10/1968, me Nr. Personal: G81031044B, lindur dhe banues ne Tirane me adrese Njesia Administrative Nr.5, Rruga "Sami Frasheri", Pallati "VEGA", Apartamenti Nr.7/1, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar identifikuar nga leternjoftimi me Nr.024444399.

QIRAMARRESI: Shoqeria "PRIMA" Sh.p.k me NIPT Nr. K32419001R, dhe Seli ne Tirane Njësia Bashkiake nr.6, Rruga "Konferenca e Pezës", ZK 8240, nr. pasurie 2/137 dhe 2/138, fabrika e shoqërisë "Bloja"sha, perfaqesuar nga Administratori znj. Odeta NAÇE e bija e Hiqmet e datelindjes 08/08/1966, me Nr. Personal: G65808036R, lindur dhe banuese ne Tirane me adrese Njesia Administrative Nr.5, Rruga "Sulejman Delvina", madhore me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar identifikuar nga leternjoftimi me Nr. 030584181.

OBJEKTI I QIRASE

Qiradhenesi eshte pronar i nje Apartamenti te ndodhur Objektivin e Shoqerise "VEGA", në adresën, Rruga "Sami Frasheri" i ndertuar nga Shoqeria "VEGA" Sh.p.k, Apartamenti ndodhet ne Katin e shtate te objektit me orientim nga jug-lindja me siperfaqe 212,66 m² (dyqind e dymbedhete presje gjashtedhete e gjashte) metra katrore.

Pronesine mbi Apartamentin qiradhenesi e verteton me Kontraten e Siper marrjes date 15/11/2002, lidhur ndermjet Shoqerise "VEGA" Sh.p.k dhe z. Artan ZENELI, vertetuar nga notere Violeta SULKAJ me Nr.7496 Rep, date 15/11/2002.

Objekti i kesaj kontrate qiraje eshte marrja me qira nga ana e qiramarresit e Apartamentit, per nje periudhe kohe dy vjecare e cila sipas deklarimit te paleve ka filluar te zbatohet ne daten 01/01/2016 dhe perfundon ne daten 31/12/2017.

QELIMI I PERDORIMIT

Apartamenti do te perdoret per banim (specialistet e huaj qe asistojne shoqerine ne periudha te ndryshme te vitit).

VLERE E QIRASE

Vlera e qirase do te jete ne masen 2000 (dymije) Euro ne muaj.

Palet kane rene dakord qe likuidimi i vleres se qirase do te behet vjetor nga qiramarresi ne favor te qiradhenesit, qe do te thote qe qiramarresi ka detyrimin qe te paguaje vleren e qirase se vitit te pare jo me vone se data 30/04/2016, pra per periudhen 01/01/2016 deri me

31/12/2016, qiramarresi ka detyrimin qe te paguaje vleren e qirase vjetore jo me vone se data 30/04/2016.

Per vitin e dyte periudha nga data 01/01/2017 deri me 31/12/2017, qiramarresi ka detyrimin qe te paguaje vleren e qirase jo me vone sa data 30/03/2017.

Palet kane rene dakord qe qiramarresi do te paguaje ne favor te qiradhenesit edhe nje shume te hollash prej 4000 (katermije) Euro (e barabarte me qirane mujore te dy muajve) shume e cila do te mbahet ne formen e garancise nga qiradhenesi deri ne perfundim te kontrates se qirase dhe me pas palet do te bejne rakordimet perfundimtare me pagesat e faturave te energjise, ujit, demtimet e mundeshme qe mund ti vijne ambjentit etj.

Vonesa e pageses me shume se dy muaj nga afati i parashikuar i jep te drejten qiradhenesit te kerkoje prishjen e njeanshme te kontrates dhe qiramarresi deklaroi se merr persiper qe te moskundershtojte prishjen e kontrates se menyre te njeanshme nga qiradhenesi per kete rast.

DETYRIMET E QIRADHENESIT

Qiradhenesi i ka dorezuar qiramarresit ambjentin ne gjendje te rregullt per banim qysh ne daten 01/01/2016.

Qiradhenesi merr persiper te zgjidhe çdo konflikt qe mund te linde ose shqetesim ne lidhje me pronesine e objektit te marre me qira nga te tretet.

DETYRIMET E QIRAMARRESIT

Qiramarresi merr persiper te mirembaje dhe te ruaje ambjentin qe eshte marre me qira. Qiramarresi nuk ka te drejte te jape ambjentin me nenqira. Ne rast demtimi te riparoje demet ose ti çdemtoje ato.

Qiramarresi do te paguaje detyrimet per furnizimin me energji elektrike, dhe uje. Qiramarresi eshte i detyruar t'i ktheje qiradhenesit banesen e marre me qira sipas afatit te kontrates, ne gjendjen qe eshte marre ne dorezim prej qiradhenesit, ne te kundert do te pergjigjet civilisht per te gjitha demet qe mund te shkaktoje, dhe qiradhenesi ka te drejte qe te mbaje nga garancia e paguar prej qiramarresit te gjithë vleften e demeve te shkaktuara, dhe ne rastin kur vlera e demeve e kalon vleren e garancise qiramarresi detyrohet qe te paguaje diferencat qe do te rezultojne. Ne rastin kur vlera e demeve eshte me e vogel se shuma e garancise, qiradhenesi pasi te zbrese vleren e demit eshte i detyruar qe ti ktheje qiramarresit pjesen tjeter te shumes se lene garanci.

Per te gjitha çeshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete kontrate do te zbatohen normat e Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, per kontraten e qirase ne veçnti dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Kjo kontrate u perpilua ne gjashte kopje dhe pasi u lexua u nenshkrua nga palet me vullnet te lire dhe te plote, para meje Noterit une e vertetoj sipas ligjit.

QIRADHENESI

Artan ZENELI

Artan Zeneli
2/10

QIRAMARRESI

Shoqeria "PRIMA" SH.A.
Perfaqesuar nga Administratori
znj. Odeta NAÇE

Odeta Naçe

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NOTER ARTAN TRESKA
RRUGA E "KAVAJES"
TEL: 0682140355